

P Z A P
I P Ž P



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 112 /2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendlodur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, paraqitur kundër menaxherit të qendrës në Zaskok, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.04.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se menaxheri i Qendrës në Zaskok 2525d/01R ka hyrë brenda në Vendvotim (VV) dhe thotë se ka të drejtë ti kontrollojë anëtarët e KVV. Vëzhguesi ynë Leonard Shala është ankuar tek kryesuesi i VV ndërsa menaxheri e ka kundërshtuar duke e pohuar që ai ka të drejtë të hyjë në VV. Sipas parashtreesit të ankesës është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore 09/2009 nen 2 paragrafi 2.8 me të cilën është përcaktuar në mënyrë decidive se kush ka të drejtë të qëndrojë në QV dhe në VV.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Ankuesi në ankesë pretendon se menaxheri i Qendrës në Zaskok 2525d/01R ka hyrë brenda në Vendvotim (VV), dhe ka thënë se të drejtë ti kontrollojë anëtarët e KVV. PZAP-i gjeti se pretendimet e tillë ankimore nuk qëndrojnë përfaktin se në ankesë nuk janë dhënë prova dhe dëshmi të cilat eventualisht do ti argumentonin pretendimet e tillë ankimore, andaj duke marr parasysh ketë, në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendor u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 112 /2012 më datën 03.05.2012.

